



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **20.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrje në pyetje e personave të arrestuar dhe verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, lidhur me caktimin e masës së sigurimit personal sipas neneve 238 dhe 234 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj personave nën hetim **Gezim Sylaj, Vasil Karasaliu, Behare Luzi, Enxhi Çelaj, Gazmend Panxha**, dhe **Sokol Sylaj**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 112 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **142**, datë **21.11.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Arrest në burg”** parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar ndaj personit nën hetim **Gezim Ram Sylaj** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Arrest në burg”** parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar ndaj personit nën hetim **Vasil Osman Karasaliu** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Arrest në burg”** parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar ndaj personit nën hetim **Behare Shyqyri Luzi** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
4. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Arrest në burg”** parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale caktuar ndaj personit nën hetim **Enxhi Altin Çelaj** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
5. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”** parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Gazmend Gani Panxha** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
6. Urdhërohet personi nën hetim **Gazmend Gani Panxha** që të paraqitet përpara oficerëve të policisë gjyqësore pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e premte, ora 15:40**.

7. Vazhdimin e masës së sigurimit ***“Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”*** parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Sokol Tahir Sylaj** me vendimin Nr. 134 Akti, datë 17.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
8. Urdhërohet personi nën hetim **Sokol Tahir Sylaj** që të paraqitet përpara oficerëve të policisë gjyqësore pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e premtë, ora 15:40.**
9. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 21.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar